



	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina	
---	--	---

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-57849/25 dt. 25.04.2025, të Fatmire Gashi, Nysret Selimi, Salih Hasolli, “Vëllezerit Asllani” sh.p.k. Selim Selimi, Nexhmije Hajdini, Muhamet Gajtani, Zahir Gajtani, Gazmend Kelmendi, Hanife Çerimi, Mentor Gajtani, Fari Zeneli nga Prishtina dhe investitorit “Vllezërit Asllani” Sh.p.k. me seli në Prishtinë, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për kompleksin me ndërtesa shumë banesore me afarizëm, ndërtuar në kuadër të bllokut urban “b-11”, të nëntërësisë “B-3”, të tërësisë hapsinore “B”, të Planit Rregullues “Muhaxhirët” dhe Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, në rrugën “Ibrahim Pacolli”, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 28.05.2025, lëshon këtë:

C E R T I F I K A T Ë E P Ë R D O R I M I T

I. I LEJOHET pronarëve Fatmire Gashi, Nysret Selimi, Salih Hasolli, “Vëllezerit Asllani” sh.p.k. Selim Selimi, Nexhmije Hajdini, Muhamet Gajtani, Zahir Gajtani, Gazmend Kelmendi, Hanife Çerimi, Mentor Gajtani, Fari Zeneli nga Prishtina dhe investitorit “Vllezërit Asllani” Sh.p.k. me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810198566, me përfaqësues Qazim Asllanaj, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-57849/25 dt. 25.04.2025, përdorimi i kompleksit me ndërtesa shumë banesore me afarizëm, të emërtuara si “Residenca 2”-“Ndërtesa B11/01” me etazhitet 3B+P+12ET, “Ndërtesa B11/02” me etazhitet 3B+S+P+13ET, “Ndërtesa B11/03” me etazhitet 3B+S+P+12ET dhe “Aneksi B11/04” me etazhitet 3B+0T, të ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-205868/20 dt. 13.10.2021, në kuadër të bllokut urban “b-11”, të nëntërësisë “B-3”, të tërësisë hapsinore “B”, të Planit Rregullues “Muhaxhirët” dhe Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë konkretisht në parcelën kadastrale nr. 10342-0, ZK Prishtinë.

II. Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhen në rrugën “Ibrahim Pacolli” ku janë dalje hyrjet e këtyre ndërtesave me numrat: 38, 40, 42, 44, 46, 48, 50, 52, 54, 56, 58, 60, 62, 64, 66, 68, 70, 72, 74, 76, 78, 80, 82 dhe 84 në Prishtinë, dhe e njëjta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njësive të tyre në evidencat e regjistrit kadastral.

IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronarët Fatmire Gashi, Nysret Selimi, Salih Hasolli, “Vëllezerit Asllani” sh.p.k. Selim Selimi, Nexhmije Hajdini, Muhamet Gajtani, Zahir Gajtani, Gazmend Kelmendi, Hanife Çerimi, Mentor Gajtani, Fari

Zeneli nga Prishtina dhe investitorit "Vllezërit Asllani" Sh.p.k me seli në Prishtinë me certifikatë të regjistrimit ARBK 810198566, me përfaqësues Qazim Asllanaj, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-57849/25 dt. 25.04.2025, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për përdorimi i kompleksit të ndërtesave shumë banesore me afarizëm, të emërtuara "Residenca 2"- "Ndërtesa B11/01" me etazhitet 3B+P+12ET, "Ndërtesa B11/02" me etazhitet 3B+S+P+13ET, "Ndërtesa B11/03" me etazhitet 3B+S+P+12ET dhe "Aneksi B11/04" me etazhitet 3B+0T, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-205868/20 dt. 13.10.2021, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, konkretisht në parcelën kadastrale nr. 10342-0, ZK Prishtinë..

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë, me referencë 09 Nr. 391/02-134013/24 dt. 31.10.2024, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Njoftimin mbi Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuarësit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografii gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të ndërtesës, nga udhëheqësi i vend ndërtimit Agon Fazliu; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Egzon Hamza; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Egzon Elshani; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Myrvete Mulaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Arbnor Haradini; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Agim Hajredini; Raportin e përfundimit të punëve për mbrojtje nga zjarri, nga Myrvete Mulaj, Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licencuar për kryerjen e matjeve kadastrale Ibrahim Junuzi me nr. të licencës 105;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht kompleksi me ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110, janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që kompleksi me ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret,

gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për kompleksin me ndërtesa shumë banesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-së

Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MJEDISIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-57849/25 DT. 2805.2025**

Zyrtari,
Berim Osmanaj

Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi

